



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Zyra e Ministrit

Office of the Minister

Kancelarija Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

LËNDA: Themelimi i Agjensisë së Akreditimit të Kosovës (AAK)

NUMËR: MASHT [I] 11/2004

DATË: 16.02.2004.

Në bazë të nenit 4.3, 4.4, 4.5, 4.6, të nenit 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 11.8, 11.9 dhe të nenit 23.3 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, Rregullorës së UNMIK-ut Nr.19/2001 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ (në vijim UA) bëhet përcaktimi i procedurave themelore për: themelimin, strukturën, statusin, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e themelimit të AAK-së.

Neni 2

Themelimi dhe statusi i AAK

- 2.1. MASHT, themelon AAK në pajtim me Ligjin e Arsimit të Lartë (në vijim LAL), si Agjensi që ushtron veprimtari të pavarur profesionale jo-fitimprurëse e cila në Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë do të garantoj cilësinë e punës arsimore dhe kërkimore-shkencore.

- 2.2. AAK, themelohet me qëllim që të vlersoj dhe akreditojë cilësinë e veprimtarisë arsimore e shkencore, shërbimeve profesionale të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) në Kosovë duke garantuar cilësinë e mësimdhënies në të gjitha Institucionet publike (IP) dhe private (IP) të Arsimit të Lartë (AL)

Neni 3

Funksionet e AAK-së

Agjensia e Akreditimit të Kosovës, funksionon duke u bazuar në ligj, përcakton standardet dhe procedurat e akreditimit, si dhe jep rekomandime për institucionet të cilat kanë kërkuar akreditim të programeve apo kurseve të tyre, ose për të cilat është kërkuar procedurë e akreditimit nga ana e MASHT.

Neni 4

Detyrat e AAK- së

AAK në përputhje me LAL dhe dokumentet tjera ndihmëse, ka për detyrë:

- a) Të vlersojë cilësinë e programeve dhe kurseve të bartësve të arsimit të lartë publik (BALP) dhe bartësve privat , duke i krahasuar parametrat e tyre me standardet e përcaktuara;
- b) Të merr vendim për akreditimin e IAL dhe të institucioneve kërkimore;
- c) Të organizojë ekipet vlerësuese për vlersimin e IAL dhe të atyre kërkimore-shkencore;
- d) Të sigurojë informacione për përmirësimin e cilësisë së Arsimit të Lartë (AL)
- e) Të koordinojë procesin e vetëvlerësimit të veprimtarisë mësimore dhe studimore të institucioneve publike (IP) dhe të atyre private (IP);
- f) Të krijojë mekanizma të cilët sigurojnë paanshmëri të vlerësimit nga ana e anëtarve të ekipeve vlerësuese dhe të KKC-së.
- g) Të bashkëpunojë me rrjetin e institucioneve evropiane (IE) dhe institucioneve tjera ndërkombëtare (IN) të garantimit të cilësisë së arsimit të lartë dhe të marrë pjesë në programet ndërkombëtare përkatëse;
- h) Të sigurojë publikun se cilësia e arsimit në IAL është e garantuar dhe e arritur;
- i) Të bëjë inspektimin e institucioneve të licencuera të arsimit të lartë;
- j) Të garantoj se fondet publike përdoren për të mbështetur cilësinë në arsimin e lartë dhe studime shkencore;
- k) T'i jepë MASHT informacione, këshilla dhe rekomandime për licencimin dhe njohjen e diplomave dhe për vlefshmerinë e programeve në arsimin e lartë;
- l) Të grumbullojë dhe të publikojë informacione për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe studimet shkencore.

Neni 5

Struktura e AAK

AAK është e ndertuar nga struktura profesionale (Këshilli Kombëtar i Cilësisë) dhe nga strukturat e përhershme administrative.

5.1. Këshilli Kombëtar i Cilësisë

- a) AAK, drejtohet nga Këshilli Kombëtar i Cilësisë (KKC), organ kolegjal që ka përgjegjësi të plotë për veprimtarinë e saj;
- b) KKC miraton kriteret e vlerësimit dhe të akreditimit të hartuara nga AAK, shqyrton kërkesën për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë mbi bazën e kriterëve të vlersimit si dhe kohën kur duhet të kryhet ky vlersim, si dhe merr vendim për akreditim të institucionit të arsimit të lartë (IAL) duke u bazuar në raportin e hartuar nga ekipet vlerësuese;
- c) KKC është përgjegjës për hartimin dhe përgatitjen e statutit të AAK-së dhe të dokumentacionit tjetër të punës për AAK-në. Statusi dhe përbërja e KKC miratohet nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- d) KKC do të përbëhet nga nëntë anëtar, prej të cilëve tre përfaqësues të sistemit të arsimit të lartë, një përfaqësues i Ministris së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe tre ekspert ndërkombëtar.
- e) Të gjithë anëtarët e Këshillit duhet të jenë ekspert në fushën e arsimit të lartë, të kenë kompetenca në vlersime dhe gjykim, si dhe të kenë aftësi të mira komunikimi. Këshilli nga radhët e veta e zgjedhë kryetarin e KKC- së me vota të hapura. Kryetari i KKC – së duhet të ketë titull të lartë akademik. Kryetari i KKC- së zgjedhet me mandat pesë vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.
- f) Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Kshillit do të përcaktohet sipas rregullativës ligjore mbi shërbimin civil.

5.2. Struktura e përhershme administrative

- a) Struktura administrative e AAK-së, i kryen të gjitha punët administrative të AAK-së. Struktura administrative, udhëhiqet nga drejtori i cili zgjidhet nga një komision i përzier i MASHT dhe KKC.
- b) Drejtori dhe personeli tjetër i AAK- së krijojn marrëdhënie pune, zgjidhen në bazë të konkursit publik, sipas kushteve dhe kriterëve të parapara në rregullativën përkatëse për rekrutimin e personelit të shërbimit civil.

Neni 6

Liria akademike

Anëtarët e KKC-së duhet të ushtrojnë detyrën e tyre bazuar në respektimin e plotë të lirisë akademike dhe pavarësisë profesionale.

Neni 7

Mënyra e marrjes së vendimeve

KKC merr vendimin për akreditim të një Institucioni të Lartë (IL) me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Këshillit.

Neni 8

Parashtrimi i kërkesës për akreditim

Procedura e akreditimit, fillon kur vetë institucioni i arsimit të lartë ose i kërkimit shkencor kërkon të vlerësohet ose kur këtë e kërkon Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 9

Procedura e akreditimit dhe riakreditimit

- a) Një bartës i arsimit të lartë që kërkon akreditim për herë të parë, bënë një kërkesë pranë AAK-së të paktën një vit përpara datës së parashikuar për marrjen e akreditimit.
- b) Vendimin për akreditim apo mos akreditim të një institucioni të arsimit të lartë, bëhet jo më vonë se se gjashtë muaj nga parashtrimi i kërkesës.
- c) Vendimin për akreditim, mirret në bazë të rezultateve të një vlersimi të mirëfillt profesional të KKC-së.
- d) Nëse rezultatet e vlerësimit janë negative, AAK i propozon MASHT të merr vendim për mosnjohjen e diplomave të IAL.
- e) Nëse rezultatet e vlerësimit, janë pozitive, AAK i propozon MASHT të nxjerrë vendim për njohjen e diplomave të IAL. Po ashtu në rast kontesti, AAK mund të vendosë për një periudhë të përshtatshme monitorimi për korrigjimin e mangësive, pra dhënies së vendimit pozitiv ose refuzimit të akreditimit.
- f) Institucioni, të cilit i është refuzuar akreditimi, mund të përsëritë kërkesën për akreditim jo më vonë se një vit.
- g) Nëse deshton për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëher i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës mund të ankohet pranë një gjykate të juridiksionit kompetent.

Neni 10

Lëshimi i certifikatave

Çertifikata e akreditimit lëshohet nga AAK.

Neni 11

Raportimi

AAK përmes zyrtarëve të përhershëm, duhet t'i raportoj MASHT për çdo vit lidhur me zhvillimet e veprimtarisë së saj.

Neni 12

Rregullat zyrtare

AAK nxjerr rregullat zyrtare të cilat miratohen nga Ministri.

Neni 13

Bashkëpunimi

Sipas Deklaratës së Bolonjës, institucionet e sigurimit të cilësisë, duhet të krijojnë një hapsirë evropiane të arsimit të lartë me qëllim bashkëpunimi në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe në mënyrë që të lehtësohet transferi i kredive, njohja e diplomave dhe shkembimi i personelit akademik dhe i studentëve. Në këtë kuadër, AAK vendosë një bashkëpunim me institucionet analoge evropiane dhe botërore.

Neni 14

Publikimi i rezultateve të vlerësimit

AAK boton materiale për sigurimin e cilësisë dhe raportet e vlerësimit dhe të akreditimit. Rezultatet e vlerësimeve të cilësisë dhe akreditimit, bëhen publike.

Neni 15

Financimi

- a. Agjensia do të financohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (për një periudhë tri vjeçare), si dhe nga donacione të organizatave dhe fondacioneve vendore e të huaja.
- b. Trajtimi financiar i të punësuarve dhe bashkëpunëtorëve të AAK-së do të kryhet sipas ligjislacionit në fuqi.
- c. Bartësit e Arsimit të Lartë Privat, marrin përsipër të gjitha shpenzimet financiare për vlerësimin dhe akreditimin tyre, në përputhje me aktet nënëligjore përkatëse.

Neni 16
Hyrja në fuqi

- a) AAK nga dita e themelimit të saj, në afat prej tre muajve e bënë hartimin e dokumentacionit profesional në bazë të të cilit do të mbeshtesë veprimtarin e vet.
- b) Udhëzim hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Ministri .

Rexhep Osmani, Ministër
